



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 248/9 Prot.

Tiranë, më 27.06.2018

V E N D I M

Nr. 60, Datë 27.6.2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KËLCYRË
MBI PËRPUTHSHMËRINË

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Këlcyrë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale (të rëndësishme), por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar. Fusha kryesore në të cilën janë konstatuar këto gabime është ajo e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik dhe e zbatimit të kontratave të punimeve.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të “Auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në Bashkinë Këlcyrë”, sipas programit të auditimit nr. 248/1 prot., datë 05.03.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A1. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve të ndërtimit, në 3 raste, për kontratat me objekt “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë”, “Rehabilitimi i kanalit Ballaban, krahu i majtë” dhe “Rikualifikimi urban i përroit në lagjen Gur”, nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se Bashkia Këlcyrë në dosjet e zbatimit nuk ka leje ndërtimi, për zbatimin e objekteve të mësipërme në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, ku citohet: “Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm: a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4. faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa që në të ardhmen, për zbatimin e kontratave për realizimin e investimeve publike, të pajisë zhvilluesit me leje zhvillimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për projektin e zbatimit me objekt “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë”, nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer oponenta teknike pasi vlera e preventivuar është më e madhe se 100 milion lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, i ndryshuar, neni 6, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të marrë masa që në të ardhmen, për zbatimin e kontratave për realizimin e investimeve publike me vlerë të preventivuar mbi 100 milionë lekë, të kryejë oponentin teknike në institucionet kompetente.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e taksave e tarifave vendore nuk janë krijuar dhe mbajtur të dokumentuar regjistrat përkatës, për të administruar dhe evidentuar të dhënat e nevojshme me numrin e plotë e të saktë për kategorinë e taksapaguesve privat e familjarë. Kjo ka sjellë programim dhe përlllogaritje të të ardhurave vendore jo në përputhje me numrin real të taksapaguesve familjar dhe privat dhe llojin e taksave që ata duhet të paguajnë, fenomen më i theksuar në Njësitë Administrative. Nga mos pasqyrimi i plotë i subjekteve dhe mos administrimi i saktë i të dhënave, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Këlcyrë në vlerën **25,356 mijë lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1-Rekomandimi: Zyra e taksave e tarifave vendore të marrë masa për të plotësimin e regjistrave për taksapaguesit privat dhe familjar me të gjithë emrat e taksapaguesve me qëllim evidentimin e dokumentimin e plotë të tyre. Kjo të shërbejë si një bazë të dhënash për hartimin me objektivitet dhe sa më real të të ardhurave. Për taksën e ndërtesës, tarifën mbi mjetet e transportit, etj., të bashkëpunohet me strukturat përkatëse si ZRPP, DRSHRR, etj.

Deri në muajin tetor 2018

4. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i mos ndjekjes së të gjitha procedurave të duhura ligjore për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore, deri në datën 31.12.2017, janë krijuar 204 debitorë privat në vlerën totale **12,447,218 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore**, veprime në kundërshtim me detyrën funksionale dhe kërkesat e kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Për taksapaguesit familjar, Bashkia Këlcyrë nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është aksionare e vetme e shoqërisë “Ujësjetllësi Këlcyrë” SHA dhe bazuar në pikën (ii) , neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore dhe do të shtonte mundësinë e rritjes së investimeve dhe shërbimeve ndaj komunitetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 15-24 të Raportit të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **12,447,218 lekë**. Për bizneset, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ndryshuar, neni 181 -*MospA. i taksave dhe tatimeve*.

4.2. Zyra e taksave dhe tarifave vendore të evidentojë dhe listojë në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës së tokës **nga fermerët**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë **edhe në median lokale** të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, njoftim vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare familjarëve të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave, gjelbërimit etj.

4.3. Për të ardhmen, për kategorinë e taksapaguesve familjar, Bashkia Këlcyrë të përgatisë dhe paraqesë për miratimin në Këshillin Bashkiak aktmarrëveshjen me shoqërinë “Ujësjetllësi Këlcyrë” SHA, duke i dhënë të drejtë kësaj shoqërie të kryej rolin e agjentit tatimor, me përfshirjen në faturën e ujit të pijshëm edhe detyrimin për taksat dhe tarifave vendore familjare.

Deri në muajin tetor 2018

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë ka një sipërfaqe toke bujqësore të pandarë prej 2,770 ha, nga e cila zyra e administrimit dhe menaxhimit të tokës bujqësore ka dhënë me qira vetëm 4.4 ha, ose 2% të saj, sipërfaqe e pa përfillshme në krahasim me sipërfaqen totale. Njëkohësisht njëësia vendore administron edhe sipërfaqen prej 7,639 ha fond pyjor e kullësor, nga e cila zyra e pyjeve dhe kullotave ka kryer procedura duke dhënë me qira vetëm sipërfaqen 1,945 ha, ose 25% të saj. Nuk ka strategji nga institucioni për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara dhe tokave të fondit pyjor e kullësor, duke mos bërë përpjekjet e duhura për të krijuar mundësi për rritjen e të ardhurave nga këto asete të njësisë vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën D.1.6, faqe 113-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për miradministrimin e tokës bujqësore dhe fondit pyjor e kullësor. Të krijohet një strategji për këtë

qëllim, duke sensibilizuar qytetarët nëpërmjet afishimeve në ambientet e bashkisë, në median lokale etj., duke nxitur forma të ndryshme të destinacionit të përdorimit të sipërfaqeve të tokave të pa ndara, si kultivimi i bimëve medicinale, e të tjera forma që janë në përshtatshmëri me kushtet dhe karakteristikat e zonës, me qëllim që nëpërmjet dhënies me qira të rritet mundësia e krijimit të të ardhurave në buxhetin e njësisë vendore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Këshilli Bashkisë Këlcyrë me paketën fiskale ka miratuar “taksën për zënie hapësire publike për tregtim artikuj të ndryshëm (taksë tregu)”, por nga strukturat përkatëse, nuk janë përcaktuar vend tregtimit, plan vendosja për çdo subjekt tregtar, ditët që do të funksionoj tregu, detyrim i përcaktuar në VKB nr. 27, datë 23.07.2008, i pa shfuqizuar, i cili ka miratuar “Tregun provizor Këlcyrë”. Nga auditimi rezulton se edhe në njësinë administrative Ballaban funksionon një tjetër “Treg provizor”, i organizuar 4 herë në muaj, i cili ka të njëjtat mangësi si tregu i mësipërm. Këto mangësi kanë ndikuar në keq menaxhimin si duhet të këtyre dy tregjeve, shoqëruar kjo me ndikime të pa matshme negative në të ardhurat e institucionit (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 15-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet strukturave përkatëse, zyrës së urbanistikës dhe zyrës së taksave e tarifave vendore, të hartojnë projektin për të përcaktuar vend ndodhjen e tregjeve në qytetin Këlcyrë dhe NJA Ballaban, planimetrinë e tyre për çdo subjekt tregtar, ditët që funksionon dhe të kërkojnë miratimin e këtij projekti në këshillin bashkiak, me qëllim miradministrimin e tregjeve dhe rritjen e të ardhurave prej tyre.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk është hartuar rregulloret e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, si dhe nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik. Nuk janë marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në asnjë nga format e përcaktuara ligjore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 16, 22, 23, 24, nenin 10 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqe 118-119 të Raportit të Auditimit*).

7.1 Rekomandim: Nga Bashkia Këlcyrë të hartohet një kuadër i plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, të cilat ndihmojnë stafin në kryerjen më mirë të detyrës funksionale. Të hartohen dhe të miratohen rregulloret e kodit të etikës, arkivës, regjistri i rrishtit, si dhe për proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion të hartohet gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës. Të merren masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Për zërin e shpenzimeve ka diferenca të dukshme midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit për shpenzimet janë realizuar në masën 58 % në vitin 2016 dhe 83% në vitin 2017. Në buxhetin vjetor nuk janë planifikuar detyrimet e prapambetura. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të planifikimit jo të mbështetur në të ardhurat reale, sjellin mos plotësimin e nevojave të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore. Zërat e shpenzimeve të buxhetit vjetor nuk rakordojnë me PBA e hartuar për këto periudha, në mos përputhje me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Nga sektori i financës hartimi i planeve buxhetore afatmesëm të bëhet i studiuar e i mbështetur në nevojat reale të njësisë vendore. Planifikimi i buxhetit vjetor të jetë vazhdim i planeve afatmesëm dhe të bëhet duke parashikuar në to të drejtat dhe detyrimet e prapambetura të njësisë vendore. Planifikimet e shpenzimeve të jenë pa fryrje artificiale, mbështetur mbi të ardhurat reale të pritshme.

Në hartimin e buxhetit të vitit 2019

9. Gjetje nga auditim: Në Bashkinë Këlcyrë nuk është bërë emërimi i Kryeinspektorit të IMTV për periudhën 2016-2017, duke sjellë mosfunksionimin dhe mospërbushjen e detyrimeve ligjore mbi mbrojtjen e territorit, në kundërshtim me nenin 1, 2, 4, 11,12 dhe 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D.1.5, faqe 108-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1 Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të marrë masa për plotësimin e strukturës së IMTV-së me Kryeinspektor me qëllim mbrojtjen e teritorit nga ndërtimet e paligjshme.

Deri në muajin tetor 2018

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë, për të gjitha asetet nuk ka hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik (*Më hollësisht trajtuar në pikën D.1.5, faqe 108-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi të saj me VKM nr. 114, datë 03.02.2008 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Përmet, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe regjistrin e pasurive të paluajtshme të dhëna me qira.

Deri në muajin tetor 2018

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Këlcyrë nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm të kryer në vitin 2016. Nga 20 rekomandime organizative është zbatuar plotësisht një, në proces zbatimi një dhe pa zbatuar 18. Për 25 rekomandime për shpërblim dëmi në vlerën totale 21,744,494 lekë, kanë dalë urdhrat e titullarit për njoftimin e subjekteve dhe personave përkatës për pagesën e detyrimit, por nuk janë marrë masa të mëtejshme, duke mos u realizuar arkëtim prej tyre. Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Agjensia e Prokurimit Publik ka vendosur gjoba për 9 persona anëtar të KVO, në vlerën totale 590,000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën F, faqe 120-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm.

Menjëherë

11.2. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të njoftojë me shkresë zyrtare KLSH në të gjitha rastet që zbatimi i rekomandimeve kalon në procese gjyqësore, si palë e tretë që ka dijeni për çështjen.

Vazhdimisht

A.2 . MASA ORGANIZATIVE NGA SHQYRTIMI I DENONCIMEVE TË BËRA NGA QYTETARËT

Bazuar në programin e auditimit, u mor në shqyrtim denoncimi i bërë nga qytetari **A. B.**, protokolluar në KLSH me nr.345, datë 20.03.2018. Në lidhje me këtë çështje, nga grupi i auditimit është trajtuar një pjesë e problematikës së ngritur nga qytetari. Nga auditimi i çështjeve të ngritura nga qytetari rezultuan gjetjet e mëposhtme:

1. Gjetje nga auditimi: Në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Këlcyrë është parashikuar “tarifë për vaditje” për kategorinë e taksapaguesve familjarë, por nga Bashkia nuk janë marrë masa për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të ngarkohen me këtë tarifë dhe si rrjedhim nuk janë vjelë të ardhurat e kësaj tarife, veprim në kundërshtim me paketën fiskale të njësisë vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën G, faqe 143-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore, specialisti i ujërave dhe kullimit, të evidentohen familjet që përdorin burimet ujore për vaditje dhe bazuar mbi nivelin e detyrimit të miratuar në paketën fiskale, të ngarkohen me detyrime për “tarifën e vaditjes” e të merren masa për arkëtimin e tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në informacionin e dhënë nga zyra e urbanistikës, për taksën e ndikimit në infrastrukturë gjendja progresive e debitorëve për këtë taksë është 1,770,523 lekë. Kjo vlerë nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare të Bashkisë, përfshin 29 subjekte private për periudhën 2010-2011 ka ardhur si rezultat i llogaritjes në detyrimit në vlerë më të vogël se përqindja e miratuar nga Këshilli Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën G, faqe 143-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,770,523 lekë, si detyrim i pa likuiduar nga 29 subjekte private, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, sipas listës në aneksin nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2010-2012, Bashkia Këlcyrë, lidhur me çështjen e ndarjes së tokave bujqësore, ka pasur 5 çështje gjyqësore me qytetarët, në të cilat ka qenë palë e paditur. Të gjitha çështjet gjyqësore kanë pasur të njëjtin objekt, detyrimin e Bashkisë të trajtojë me tokë bujqësore qytetarët, sipas ligjit 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Në përfundim të gjykimit të shkallës së parë për të pesë vendimet e gjykatës, Bashkia Këlcyrë është humbëse e procesit, por në asnjë rast institucioni nuk ka ndjekur ankimimin në shkallët e tjera të gjykimit, duke mos ushtruar hapësirat dhe kompetencat ligjore për mbrojtjen e interesave të institucionit. Katër vendime gjyqësore të shkallës së parë janë zbatuar nëpërmjet përmbaruesve gjyqësor, ndërsa vendimi nr. 220, datë 11.07.2011, për trajtimin me tokë bujqësore të qytetares **A. S.**, nuk është zbatuar dhe as nuk është apeluar nga Bashkia Këlcyrë, duke lënë të pa zgjidhur problemin për qytetaren (*Më hollësisht trajtuar në pikën G, faqe 143-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore, të ndjekë këto procese me përfaqësues të saj në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim mbrojtjen e interesave të njësisë vendore. Të trajtojë dhe zgjidhë sipas hapësirave ligjore çështjen ende të pazgjidhur të qytetares **A.S.** për tokën bujqësore.

Menjëherë

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësorisë, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **38,657,994 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe BOE “S.” SHPK & “R.” SHPK u konstatua se për zërin “Furnizim vendosje hekur beton periodik Ø 6-10 mm” janë situacionuar 8.084 ton hekur me shumë nga sasia e preventivit aktual të ndryshuar dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **989,461 lekë me TVSH** (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa që në situacionin përfundimtar të kontratës “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë”, t’i zbrësë BOE “S.” SHPK & “R.” SHPK shumë prej **989,461 lekë me TVSH**, për volum punimesh të pa përfshira në preventivin e miratuar.

Në hartimin e situacionit përfundimtar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Rikualifikimi urban i perroit në lagjen Gur”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Këlcyrë dhe BOE “H. 94 & E.” SHPK, u konstatua se nga autoriteti kontraktor nuk është mbajtur penaltet në vlerën prej **162,488 lekë me TVSH** ndaj kontraktorit, për shkelje të afateve kontraktuale, veprim në kundërshtim me nenin 5 dhe me nenin 33 germa (a) të kontratës (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **162,488 lekë me TVSH** nga BOE “H. 94” SHPK & “E.” SHPK, si dëme të likuidueshme për shkelje të afateve të kontratës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rehabilitimi i kanalit Ballaban, krahu i majtë”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe Kontraktuesit BOE “2A.” SHPK & “S.” SHPK, u konstatua se autoriteti kontraktor ka likuiduar më tepër për diferenca në volume të punimeve dhe për mos rakordim vlerash në situacionin përfundimtar, vlerën **118,440 lekë me TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 91-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **118,440 lekë me TVSH** nga BOE “2.” SHPK & “S.” SHPK, për diferenca në volume punimesh të pakryera dhe mos rakordim vlerash në situacionin përfundimtar.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Sukë - Zhepovë, Loti 1, zhvilluar në datën 22.02.2017, me fond limit 62,499,987 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE "N." SHPK & "R." SHPK**, me vlerë të ofertës 62,075,361 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe është s'kualifikuar operatori ekonomik "B.B" SHPK prej 51,803,050 lekë pa TVSH i ndodhur në të njëjtat kushte. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar, pasi asnjë ofertë nuk është e vlefshme. Mos kryerja e këtij veprimi ka shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 10,272,311 lekë**, si diferencë midis 2 ofertave të ndodhura në të njëjtat kushte, veprim në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; ", nenin 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave: z. **A.L.**, zj. **R.H.**, z. **A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **10,272,311 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- z. **A.L.** me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **3,424,104 lekë**.

2- zj. **R.H.** me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **3,424,104 lekë**.

3- z. **A.Q.** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **3,424,104 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rrjetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 124,090,700 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE "S." SHPK & R." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 123,985,927 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe është s'kualifikuar operatori ekonomik BOE "B.9" SHPK & BE-IS" SHPK me vlerë të ofertës ekonomike 114,804,173 lekë pa TVSH, i cili ndodhet në të njëjtat kushte plotësimi të kriterëve për kualifikim. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar, pasi asnjë ofertë nuk është e vlefshme. Mos kryerja e këtij veprimi ka shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 9,181,754 lekë pa TVSH**, si diferencë midis 2 ofertave të ndodhura në të njëjtat kushte, veprim në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; ", nenin 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave: z. **A.L.**, zj. **R.H.**, z. **A.Q.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 62-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **9,181,754 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- z. **A.L.** me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **3,060,585 lekë**.

2- zj. **R.H.** me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **3,060,585 lekë**.

3- z. **A.Q.** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **3,060,585 lekë**.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rikualifikimi i bllokut të banesave e fasadave në rrugën hyrëse", me fond limit 58,676,804 lekë pa TVSH, zhvilluar në muajin nëntor 2016, është shpallur fitues **BOE "L.K." SHPK & "F." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 58,510,833 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe, është

s'kualifikuar padrejtësisht **BOE "B. & P.V." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 51,032,790 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave për buxhetin e njësisë vendore është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 7,478,043 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: **z. A.L., zj. R.H., z. A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **7,478,043 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- **z. A.L.**, me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **2,492,681 lekë**.

2- **zj. R.H.**, me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **2,492,681 lekë**.

3- **z. A.Q.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **2,492,681 lekë**.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Skema ujitëse Ballaban, (Ujitja e fushës Ballaban, vazhdim)", zhvilluar në datën 15.06.2017, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE "S." SHPK & "2." SHPK** me vlerë të ofertës 20,796,724 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është s'kualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik **"S.C." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 16,248,932 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 4,547,729 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: **z. A.L., zj. R.H., z. A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 79-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **4,547,729 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- **z. A.L.** me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **1,515,930 lekë**.

2- **zj. R.H.** me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **1,515,930 lekë**.

3- **z. A.Q.** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **1,515,930 lekë**.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të rezervuarve Këlcyre dhe Varibop", zhvilluar në datën 27.11.2017, me vlerë të fondit limit 16,005,490 lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë 9 OE, nga të cilët është shpallur fitues **BOE "E." SHPK & "A." SHPK**, i renditur i nënti në radhë, me vlerë të ofertës ekonomike më të lartë prej 15,952,517 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret për kualifikim të vendosura në DST dhe është s'kualifikuar padrejtësisht **OE "N." SHPK**, me vlerë të ofertës 12,564,759 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 3,387,758 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5; nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi

komisioni i vlerësimit të ofertave: **z. A.L., zj. R.H., z. A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 73-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **3,387,758 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- 1- **z. A.L.**, me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **1,129,253 lekë**.
- 2- **zj. R.H.**, me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **1,129,253 lekë**.
- 3- **z. A.Q.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **1,129,253 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Përmirësim kushte të banimit të komunitetit rom e egjiptian”, me fond limit 6,593,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, është shpallur fitues **BOE “A. & E.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 6,540,560 lek pa TVSH dhe është s’kualifikuar padrejtësisht **OE “F.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 4,972,324 lekë pa TVSH. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave për njësinë vendore është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 1,568,236 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: **z. A.L., zj. R.H., z. A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 50-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **1,568,236 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- 1- **A.L.** me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **527,745 lekë**.
- 2- **R.H.** me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **527,745 lekë**.
- 3- **A.Q.** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **527,745 lekë**.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Shtrimi i pjesëve të vështira të rrugëve rurale dhe përmirësimi i këmbeve të urave me beton”, zhvilluar në datën 18.09.2017, me vlerë të fondit limit 14,166,666 lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë 5 OE, nga të cilët është shpallur fitues **BOE “A. & H. 94” SHPK** me vlerë të ofertës 12,488,243 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është s’kualifikuar padrejtësisht **OE “E.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 11,698,469 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret për kualifikim të vendosura në DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 789,774 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: **z. A.L., zj. R.H., z. A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 82-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Këlcyrë të marr masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **789,774 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

- 1- **z. A.L.** me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **263,258 lekë**.
- 2- **zj. R.H.** me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, për shumën **263,258 lekë**.

3- **z. A.Q.** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **263,258 lekë**.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Blerje automjete (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues)”, zhvilluar në muajin dhjetor 2016, përsëritur procedura 3 herë, në radhën e dytë të zhvillimit të procedurës është s’kualifikuar padrejtësisht **OE “S. & C.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 5,188,000 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret e vendosura në DST. Në radhën e tretë të zhvillimit të procedurës “Me negociim pa shpallje paraprake të kontratës”, është rritur në mënyrë të pa argumentuar fondi limit dhe është shpallur fitues operatori ekonomik **“R.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 5,350,000 lekë. Si rezultat i s’kualifikimit padrejtësisht të OE “S. & C.” SHPK, është shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 162,000 lekë** ndaj buxhetit të njësisë vendore, si rezultat i diferencës midis dy ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b, d, dh; nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a, c; nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3; 5; nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Ngarkohen me përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave: **z. A.L., z. F.L., z. A.Q.** (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 40-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1-Rekomandim: Bashkia Këlcyrë të marr masat dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **162,000 lekë pa TVSH**, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:

1- **z. F.L.**, person i kontaktuar nga jashtë institucionit, për shumën **54,000 lekë**.

2- **z. A.L.** me detyrë specialist i kadastrës, për shumën **54,000 lekë**.

3- **z. A.Q.** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore për shumën **54,000 lekë**.

Menjëherë

B2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Për shkak të mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, në 1 rast, nga komisioni i vlerësimit të ofertave është kualifikuar operatori ekonomik në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke u kualifikuar e shpallur fitues në kushtet kur nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në DST, me pasojë **përdorim të fondeve publike me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të ulët** në vlerën totale të kontratës prej **3,300,000 lekë pa TVSH**. Në një rast nga autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë është bërë likuidimi i kontratës me vlerë totale 6,480,000 lekë me TVSH dhe marrja në dorëzim e mjeteve (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues), pa plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, jashtë kushteve teknike, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të ulët** në vlerën totale të kontratës prej **6,480,000 lekë**.

Shkeljet e konstatuara në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi:

1.a: Në tenderin me objekt "Blerje automjet kundër zjarrit (Blerje mjet zjarrfikës)" zhvilluar në datën 12.10.2017, me vlerë të fondit limit 3,333,333 lekë pa TVSH, ka marrë pjesë dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues 1 operatorë ekonomik, **"R." SHPK**, me vlerë të ofertës 3,300,000 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret e DST. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar dhe mos

kryerja e këtij veprimi vlerësohet kualifikim i operatorëve ekonomik në kundërshtim me kërkesat ligjore, si dhe përdorim i vlerës së kontratës prej **3,300,000 lekë pa TVSH me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të ulët**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet si vijon: neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b/d/dh, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a/b/c; neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe 5, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1 dhe 5, germa a, (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 88-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.b. Në tenderin me objekt “Blerje automjete (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues)”, zhvilluar në muajin dhjetor 2016, nga autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë është bërë likuidimi i kontratës me vlerë totale 6,480,000 lekë me TVSH dhe marrja në dorëzim e mjeteve të mësipërme, pa plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, jashtë kushteve teknike. Kryerja e këtij veprimi vlerësohet përdorim i vlerës së kontratës prej **6,480,000 lekë** me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të ulët (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 41-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Këlcyrë, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës, mallit dhe shërbimit. Në rastet e marrjes në dorëzim të mjeteve, të mos pranohen nga autoriteti kontraktor nëse nuk plotësojnë kriteret e specifikimet e vendosura në DST.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

I. Referuar parregullsisve dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 7 punonjësve, për procedurat e prokurimit si më poshtë:**

a. Për 4 anëtarët e njësisë së prokurimit, hartues të dokumenteve standarde të tenderit:

- 1. M. M. (L.),** me detyrë përgjegjëse e burimeve njerëzore;
- 2. B. I.,** me detyrë përgjegjës i urbanistikës;
- 3. S.V.,** me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore;

4. V. K., me detyrë specialist i ujërave dhe kullimit, *për shkeljet në hartimin e kritereve dhe dokumenteve standarde, në tenderat e mëposhtëm:*

1. Tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Sukë - Zhepovë, Loti 1, zhvilluar në datën 22.02.2017, me fond limit 62,499,987 lekë.
2. Tenderin me objekt "Rrjetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë, zhvilluar në datën 27.06.2017 me fond limit 124 090 700 lekë.
3. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Rezervuarëve Këlcyrë dhe Varibop, zhvilluar në datën 27.11.2017, me fond limit 16,005,490 lekë

b- Për 3 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

1. **A.L.**, me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).
2. **R.H.**, me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).
3. **A.Q.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), *për shkeljet e mëposhtme:*

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c; nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1 dhe 5, germa a, për mos zbatim të kritereve të vendosura në DST në procesin e shqyrtimit të ofertave, në 8 procedura prokurimi, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 37,387,605 lekë**, si më poshtë:

- Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Sukë - Zhepovë, Loti 1, zhvilluar në datën 22.02.2017, me fond limit 62,499,987 lekë pa TVSH, me pasojë dëm ekonomik në **vlerën 10,272,311 lekë**,
- Në tenderin me objekt "Rrjetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 124,090,700 lekë pa TVSH, me pasojë dëm ekonomik në **vlerën 9,181,754 lekë pa TVSH**,
- Në tenderin me objekt "Rikualifikim i bllokut të banesave e fasadave në rrugën hyrëse", me fond limit 58,676,804 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 7,478,043 lekë pa TVSH**.
- Në tenderin me objekt "Skema ujitëse Ballaban, (Ujitja e fushës Ballaban, vazhdim)", zhvilluar në datën 15.06.2017, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë pa TVSH, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 4,547,729 lekë**
- Në tenderin me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Rezervuarëve Këlcyre dhe Varibop", zhvilluar në datën 27.11.2017, me vlerë të fondit limit 16,005,490 lekë pa TVSH, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 3,387,758 lekë**.
- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Përmirësim kushte të banimit të komunitetit rom e egjiptian", me fond limit 6,593,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 1,568,236 lekë pa TVSH**.
- Në tenderin me objekt "Shtrimi i pjesëve të vështira të rrugëve rurale dhe përmirësimi i këmbeve të urave me beton", zhvilluar në datën 18.09.2017, me vlerë të fondit limit 14,166,666 lekë pa TVSH, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 789,774 lekë pa TVSH**.
- Në tenderin me objekt "Blerje automjete (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues)", zhvilluar në muajin dhjetor 2016, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 162,000 lekë**.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe **të nenit 9** të kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2015, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 6 punonjësit e mëposhtëm:**

I. “Vërejtje” për punonjësit e mëposhtëm:

1. A. P., me detyrë punonjësi i policisë Bashkiake, *për shkeljet e mëposhtme:*

- Nuk janë hartuar planet e vendosjes në shërbim, ku të përcaktohej territori, objekti, detyrat e ngarkuara.
 - Nuk është përgatitur dhe mbajtur libri i shërbimit 24 orësh, ku të pasqyrohej vendosja në shërbim e punonjësit të policisë, detyrat e dhëna, problemet e dala gjatë kontrolleve të ushtruara gjatë kryerjes së shërbimit.
 - Nuk janë ushtruar kontrole për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, për respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në treg.
- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme “Tip” të Policisë Bashkiake.

II. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. V. K., me detyrë përgjegjëse e financës, *për shkeljet e mëposhtme:*

- Për mos kontabilizimin e detyrimit të dëmit ekonomik në vlerën 21,744,494 lekë të lënë në rekomandimet e KLSH në auditimin e mëparshëm.
- Për mos kontabilizim të debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për 204 subjekte private në vlerën 12,447,218 lek në fund të vitit 2017.
- Për mos krijimin e regjistrit të aktiveve të njësisë vendore.
- Për mos përfshirjen në buxhetin vjetor të detyrimeve afatshkurtra ndaj të tretëve dhe mos hartimin e buxhetit vjetor në përputhje me PBA për vitin 2016 dhe 2017.

2. V. K., me detyrë specialist i ujërave dhe kullimit *për shkeljet e mëposhtme:*

- Për mos evidentim të numrit të taksapaguesve familjar të cilët duhet të ngarkohen me detyrimin e tarifës së vaditjes e si rezultat për mos arkëtimin e kësaj takse në Bashkinë Këlcyrë, duke mos pasur asnjë të dhënë, në kundërshtim me paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

III. Zgjidhje të kontratës së punës për tre punonjësit e mëposhtëm:

1. A.L., me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).

2. R.H., me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).

3. A.Q., me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), për shkeljet e mëposhtme:

a) Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c; nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1 dhe 5, germa a, për mos zbatim të kritereve të vendosura në DST në procesin e shqyrtimit të ofertave, në 8 procedura prokurimi, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 37,387,605 lekë**, si më poshtë:

- Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Sukë - Zhepovë, Loti 1, zhvilluar në datën 22.02.2017, me fond limit 62,499,987 lekë pa TVSH, me pasojë dëm ekonomik në **vlerën 10,272,311 lekë**,

- Në tenderin me objekt "Rrjetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 124,090,700 lekë pa TVSH, me pasojë dëm ekonomik në **vlerën 9,181,754 lekë pa TVSH**,

- Në tenderin me objekt “Rikualifikim i bllokut të banesave e fasadave në rrugën hyrëse”, me fond limit 58,676,804 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 7,478,043 lekë pa TVSH**.

- Në tenderin me objekt "Skema ujitëse Ballaban, (Ujitja e fushës Ballaban, vazhdim)", zhvilluar në datën 15.06.2017, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë pa TVSH, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 4,547,729 lekë**

-Në tenderin me objekt “Rehabilitim i skemës ujitëse të Rezervuarve Këlcyre dhe Varibop”, zhvilluar në datën 27.11.2017, me vlerë të fondit limit 16,005,490 lekë pa TVSH, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 3,387,758 lekë**.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Përmirësim kushte të banimit të komunitetit rom e egjiptian”, me fond limit 6,593,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 1,568,236 lekë pa TVSH**.

- Në tenderin me objekt “Shtrimi i pjesëve të vështira të rrugëve rurale dhe përmirësimi i këmbeve të urave me beton”, zhvilluar në datën 18.09.2017, me vlerë të fondit limit 14,166,666 lekë pa TVSH, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 789,774 lekë pa TVSH**.

-Në tenderin me objekt “Blerje automjete (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues)”, zhvilluar në muajin dhjetor 2016, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 162,000 lekë**.

D.2. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Këlcyrë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë që për këta persona të mos propozohet masë, si më poshtë:

1. R.H. me detyrë specialist i pyjeve dhe kullotave;

2. A. M. me detyrë specialist i pyjeve dhe kullotave;

3. E. D., me detyrë specialist i pyjeve dhe kullotave;

4. D. M. me detyrë administrator i Njësisë Administrative Ballaban;

5. D. K. (K.), me detyrë administrator i Njësisë Administrative Dishnicë;

6. S. I., me detyrë administrator i Njësisë Administrative Sukë.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko-juridik nga ana e Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, **për 3 personat si më poshtë:**

- 1. A.L.**, me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).
- 2. R.H.**, me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).
- 3. A.Q.**, me detyrë inspektor i taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), *për shkeljet e mëposhtme në procedurat e prokurimit publik:*

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika b/d/dh, nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika a/b/c; nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe 5, neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1 dhe 5, germa a, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 37,387,605 lekë pa TVSH**, në 8 procedura prokurimi si më poshtë:

1- Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Sukë - Zhepovë, Loti 1, zhvilluar në datën 22.02.2017, me fond limit 62,499,987 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE “N.” SHPK & “R.” SHPK**, me vlerë të ofertës 62,075,361 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe është s’kualifikuar operatori ekonomik **“B.B” SHPK** prej 51,803,050 lekë pa TVSH. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar, e mos kryerja e këtij veprimi ka shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 10,272,311 lekë**, si diferencë midis 2 ofertave të ndodhura në të njëjtat kushte.

2- Në tenderin me objekt "Rrjetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër-Këlcyrë, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 124,090,700 lekë pa TVSH, është kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE “S.” SHPK & R.” SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 123,985,927 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura në DST dhe është s’kualifikuar operatori ekonomik **BOE “B.9” SHPK & BE-IS” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 114,804,173 lekë pa TVSH. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar, e mos kryerja e këtij veprimi ka shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 9,181,754 lekë pa TVSH**, si diferencë midis 2 ofertave të ndodhura në të njëjtat kushte.

3- Në tenderin me objekt “Rikualifikim i bllokut të banesave e fasadave në rrugën hyrëse”, me fond limit 58,676,804 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, është shpallur fitues **BOE “L.K.” SHPK & “F.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 58,510,833 lekë pa TVSH i cili nuk plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST dhe, është s’kualifikuar padrejtësisht **BOE “B. & P.V.” SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 51,032,790 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 7,478,043 lekë pa TVSH**, si diferencë midis dy ofertave.

4- Në tenderin me objekt "Skema ujitëse Ballaban, (Ujitja e fushës Ballaban, vazhdim)", zhvilluar në datën 15.06.2017, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë pa TVSH, është

kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE "S." SHPK & "2." SHPK** me vlerë të ofertës 20,796,724 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe është s'kualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik **"S.C." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 16,248,932 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e DST. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 4,547,729 lekë.**

5-Në tenderin me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse të Rezervuarve Këlcyre dhe Varibop", zhvilluar në datën 27.11.2017, me vlerë të fondit limit 16,005,490 lekë pa TVSH, është shpallur fitues **BOE "E." SHPK & "A.K." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 15,952,517 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST dhe, është s'kualifikuar padrejtësisht **OE "N." SHPK**, me vlerë të ofertës 12,564,759 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 3,387,758 lekë** si diferencë midis dy ofertave.

6- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Përmirësim kushte të banimit të komunitetit rom e egjiptian", me fond limit 6,593,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, është shpallur fitues **BOE "A.K. & E." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 6,540,560 lekë pa TVSH dhe është s'kualifikuar padrejtësisht **OE "F." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 4,972,324 lekë pa TVSH. Si rezultat i diferencës midis dy ofertave për njësinë vendore është krijuar **dëm ekonomik në vlerën 1,568,236 lekë pa TVSH**

7- Në tenderin me objekt "Shtrimi i pjesëve të vështira të rrugëve rurale dhe përmirësimi i këmbeve të urave me beton", zhvilluar në datën 18.09.2017, me vlerë të fondit limit 14,166,666 lekë pa TVSH, është shpallur fitues **BOE "A. & H. 94" SHPK** me vlerë të ofertës 12,488,243 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST dhe, është s'kualifikuar padrejtësisht **OE "E." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 11,698,469 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e kualifikimit të vendosura në DST, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 789,774 lekë pa TVSH** si diferencë midis dy ofertave.

8- Në tenderin me objekt "Blerje automjete (fadromë, autoveturë, automjet vetëshkarkues)", zhvilluar në muajin dhjetor 2016, përsëritur procedura 3 herë, në radhën e dytë të zhvillimit të procedurës është s'kualifikuar padrejtësisht **OE "S. & C." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 5,188,000 lekë pa TVSH, i cili i plotëson kriteret e vendosura në DST. Në radhën e tretë të zhvillimit të procedurës "Me negociim pa shpallje paraprake të kontratës", është rritur në mënyrë të pa argumentuar fondi limit dhe është shpallur fitues operatori ekonomik **"R." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 5,350,000 lekë. Për arsye të s'kualifikimit padrejtësisht të **OE "S. & C." SHPK**, është shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 162,000 lekë** ndaj buxhetit të njësisë vendore, si rezultat i diferencës midis dy ofertave.

9- Në tenderin me objekt "Blerje automjet kundër zjarrit (Blerje mjet zjarrfikës)" zhvilluar në datën 12.10.2017, me vlerë të fondit limit 3,333,333 lekë pa TVSH, ka marrë pjesë dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues 1 operatorë ekonomik, **"R." SHPK**, me vlerë të ofertës 3,300,000 lekë, i cili nuk i plotëson kriteret e DST. Nga KVO tenderi duhet të ishte anuluar dhe mos kryerja e këtij veprimi vlerësohet kualifikim i operatorëve ekonomik në kundërshtim me kërkesat ligjore, si dhe përdorim i vlerës së kontratës prej **3,300,000 lekë pa TVSH me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të ulët.**

F. TË TJERA

Në vazhdim të problemeve të trajtuara në pikën A.2 të Vendimit në lidhje më denoncimin e bërë nga qytetari **A. B.**, për çështjet e mbyllura nga organi i Prokurorisë, të kontaktohet qytetari nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Kryeaudituesi, nëse ka probleme që mund të thellohen në trajtimin tonë, apo nëse ka dokumente shtesë për punonjësen **M.A.**, që denoncohet se gjatë vitit 2016 është paguar duke qenë jashtë shtetit.

Për këtë të fundit KLSH do t'i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për verifikim nëpërmjet sistemit TIMS. Më tej çështja të përcillet në organet përkatëse.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

BUJAR LESKAJ

K R Y E T A R